



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

I.Numër: 400/01-32123, datë: 29 Maj 2026.

Në bazë të nenit 11 dhe nenit 12. 2. pika d) të Ligjit Nr.03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4. dhe nenin 64. paragrafi 1, të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, Numër: 01-016/01-413431, datë: 30.Shtator 2020, ne propozim të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Pejës, në takimin e mbajtur me datë: 29 Maj 2026 , merr këtë:

VENDIM

Nr.37/2026

Mbi kompensimin e anëtareve të Komisionit të veçantë për tituj nderi, dekorata, medalje, mirënjohje dhe falënderime për vitin 2026

1. MIRATOHET vendimi për kompensimin e anëtareve të Komisionit të veçantë për tituj nderi, dekorata, medalje, mirënjohje dhe falënderime për vitin 2026, në shumën prej 50,00 € (pesëdhjetë euro) për takim, sipas listës së nënshkrimeve dhe procesverbaleve të mbajtura.
2. Komisioni i veçantë për tituj nderi, dekorata, medalje, mirënjohje dhe falënderime për vitin 2026 është themeluar nga Kuvendi i Komunës së Pejës me Vendimin Nr. 10-2026 Mbi formimin e Komisionit të veçantë për tituj nderi, dekorata, medalje, mirënjohje dhe falënderime për vitin 2026, nr. Prot: 01-060/01-12407, datë: 26 Shkurt 2026.
3. Për Zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryesuesi i Kuvendit të Komunës në bashkëpunim me Drejtorin për Buxhet e Financa.
4. Ky vendim shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në web-faqen e Komunës së Pejës.

Vendimi ti dërgohet:

MAPL,

Kryetarit të Komunës,

Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,

Arkivë.



KRYESUESI I KUVENDIT,
z. Rexhep Kurtbogaj